

Titulli i kursit (lëndës mësimore): Siguria e Informacionit (obligative, master semestri I, 6 ECTS)

Qëllimi i kursit (modulit): Kjo lëndë ka për qëllim tu ofrojë studentëve njohuri të gjerë në lidhje me sigurimin e informacionit dhe konceptet e sigurisë, algoritmet kriptografike, të kuptuarit e çështjeve te ndryshme në lidhje sistemet e informacionit dhe rreziqet e tyre të sigurisë, të vlerësojnë rëndësinë e sigurisë së informacionit, mbrojtjen e informacionit, qasja në sistemet e informacionit, legjislacioni dhe standardet industriale.

Rezultatet e pritura të nxënies: Pas përfundimit të këtij kursi (lënde) studenti duhet të ketë njohuri në lidhje me: (1) Informacionit dhe Sistemet e Informacionit, (2) Të identifikojë kërcënimet e një rrjeti kompjuterik: ndërhyrjet, refuzimi i shërbimit, sulmet, dhe malware. (3) Vlerëson gjasat e një sulmi në kompjuterët personal dhe gjasat sulmit në rrjetë. (4) Rëndësinë e ruajtjes së aseteve të informacionit. (5) Terminologjitë e sigurisë së informacionit dhe algoritmet e avancuara kriptografike. (6) Siguria e bazës së të dhënave. (7) Siguria e softuerit dhe sistemit operativ.

Përmbajtja e lëndës: Konceptet e informacionit, Sistemeve të informacionit, dhe menaxhimin e sistemit të informacionit; Vetëdijesimi në lidhje me sigurinë e informacionit: edukimi, trajnimi, mundësitë profesionale; Konceptet e Sigurisë së Informacionit: Konfidencialiteti, Integriteti, Disponueshmëria, Autentikimet dhe Autorizimet, Konfigurimet dhe Kontrollat, Auditimet, Poliset, Menaxhimi i Rrezikut; Fjalekalimet vs. Çelësat kriptografik, Siguria e databazes, Masat e Sigurimit të Informacionit: Procedurat, Praktikat Industriale; Aspektet e sigurisë fizike, Alarmet dhe struktura e raportimit, Siguria e Softuerit dhe sistemit operativ. Siguria dhe AI.

Metodologjia e mësimdhënies:

45 orë ligjërata dhe 30 orë ushtrime laboratorike. Afërsisht 75 orë pune të pavarur përfshirë edhe detyrat praktike në grup si detyra shtëpie dhe punimin seminarik në gjuhën angleze.

Vlerësimi:

Vijueshmëria dhe aktiviteti në klase: 10%, detyrat praktike 40 %, provimi final 50 %

Literatura bazë :

1. Mark Stamp, Information Security – Principles and Practice, Wiley, 2nd Edition, 2011
2. Merkow, M, Breithaupt, J, Information Security: Principles and Practices Prentice Hall ISBN: 0-13-154729-1, 2006
3. Cryptography and Network Security, by William Stallings, ISBN=0-13-187316-4, published by Prentice Hall, 2006.